



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punës dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 84

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

Prishtinë, më 4 dhjetor 2013, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Flora Brovina, Gëzim Kelmendi dhe Bekim Haxhiu.

Munguan: Sasha Gjokiq dhe Liburn Aliu.

I ftuar : **Ferid Agani**, Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë dhe **Arianit Jakupi**, u.d. kryeshef i AKPM-së .

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, koordinatorë e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 19.11. 2013 dhe 22.11. 2013 ;
3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Ferid Agani ;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 19.11. 2013 dhe 22.11. 2013;

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të datës 19.11. 2013 dhe 22.11. 2013.

3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Ferid Agani;

Fikrim Damka- Tha se e kemi parapa këtë takim me ministrin, të diskutojmë disa çështje të sektorit të shëndetësisë e sidomos sa i përket sektorit farmaceutik. Ligji i shëndetësisë është miratuar tash e 9 muaj, dhe dëshirojmë të njoftohemi se si ka ecur zbatimi i këtij ligji.

Ferid Agani – Falënderoi për ftesën dhe shprehi gatishmëri që të diskutojë me anëtarët e komisionit për zbatimin e Ligjit të shëndetësisë, por edhe për problemet tjera, me të cilat ballafaqohet sektori i shëndetësisë. Fillimisht sa i përket Ligjit të shëndetësisë, tha se pas miratimit të Ligjit, ministria menjëherë ka filluar me nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Së pari ka nxjerr udhëzimin administrativ për listën e kujdesit shëndetësor themelor, udhëzimin administrativ për stimulimet e performancës, disa rregullore për riorganizimin e brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë. Kemi arritur ta konstituojmë edhe Odën e Mjekëve dhe kemi punuar edhe në hartimin e ligjit për sigurime shëndetësore. Në punën rreth këtij projektligji kemi bashkëpunuar edhe me FMN-në dhe BB-në.

Kemi pasur bashkëpunim edhe me donatorët për çuarjen përpara të reformës shëndetësore dhe kjo është parë si një projekt kualitativ dhe i domosdoshëm dhe si e tillë është mbështet nga BB-ja me një financim prej 25.6 milionë dollarësh për 5 vitet e ardhshme. Përpos BB-së, me grand ka hy në mbështetje të reformës Qeveria e Zvicrës me 8 milion franga zvicerane dhe Qeveria e Luksemburgut me 6 milion euro për periudhën 4 vjeçare.

Sa i përket ligjit të shëndetësisë, Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe statutin e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar. Tani jemi në procedurat e zgjedhjes dhe themelimit të organeve të parapara për këtë shërbim.

Kemi parapa që deri në fund të muajit prill, ti kemi në fuqi të gjitha aktet e parapara për zbatimin e ligjit të shëndetësisë.

Sa i përket buxhetit, kemi paraqit kërkesat tona. Kërkesat kanë qenë shumë më të mëdha sesa buxheti që na është ndarë. Kemi paraparë gjithsej 117 milionë euro për kujdesin dytësor dhe tretësor, e që paraqet një rritje prej 8 milion euro prej viti 2013.

Nevojat reale vetëm për barna dhe material harxhues, janë diku 40 milionë euro, e ne kemi vetëm 21 milionë euro.

Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë ka qenë që në buxhetin e vitit 2014, të akomodohen edhe tri (3) hua, të cilat Ministria e Shëndetësisë i ka siguruar me donatorë ndërkombëtarë, konkretisht me Bankën Islamike për Zhvillim, Fondin Saudit për Zhvillim dhe Fondin Kuvajtian për Zhvillim. Bordet ekzekutive të këtyre institucioneve kanë ndarë huan për sektorin e shëndetësisë

të Kosovës, por Ministria e Financave nuk arriti ti akomodojë këto hua të buta me një periudhë kthimi prej 20 vjet , me një periudhë të ngrirjes prej 5 viteve, dhe me një këst prej 2 %.

Edhe pse Qeveria e Kosovës nuk ishte e gatshme për këto hua, oferta e tyre vazhdon të jetë e hapur.

Kam shprehur pakënaqësinë time në Qeveri për këtë situatë me huat, por edhe për mospërfshirjen e punësimit të 120 punëtorëve të ri në sektorin e shëndetësisë , dhe kjo rezultoi edhe me votimin tim kundër buxhetit .

Pa këtij takimi, u zhvilluan diskutime plotësuese me ministrin e financave dhe gjetëm zgjidhjen për 120 punëtorët e ri, ku gjysma e tyre u akomodua menjëherë në buxhetin e vitit 2014, ndërsa gjysma tjetër do të akomodohej me rishikimin e buxhetit, ndërsa çështja e huave mbeti e hapur dhe do të shikohen mundësitë e mëtejshme për vitet pasuese.

Time Kadrijaj – Tha se çështjet që do ti adresojë janë fillimisht, çështja e pagave të specializantëve, dhe e dyta, pagat e mjekëve të sapo diplomuar, që është parapa me ligjin e shëndetësisë, që gjatë amendamentimit të ligjit të shëndetësisë, keni thënë se janë siguruar mjetet për punësimin e 300 mjekëve të ri për çdo vit. Pastaj, çështje tjetër është edhe çështja e barnave të listës esenciale. Mendoj se rritja prej 8 milion euro e buxhetit të shëndetësisë është e vogël dhe e pamjaftueshme, por përveç buxhetit të vogël, ka disa vite që shëndetësia përballlet edhe me probleme menaxheriale. Çka keni ndërmarrë në këtë drejtim?

Si shembull është laparoscopia në QKUK, që ka kohë që nuk punon për shkak të një tavoline pune dhe shumë problemeve tjera.

Ferid Agani – Tha se në punën tonë ka edhe rezultate por ka mjaft probleme dhe fokusimi ynë është te problemet. Sa i përket specializantëve , të gjithë specializantët i kemi përfshi në pagesë . Do ta hapim kursin edhe për 60 specializantë të ri.

Sa i përket specialistëve , tani i kemi në Kosovë 62 mjekë specialistë të papunë. Për 35 prej tyre, do të hapet konkursi për ata të cilët janë afro 9 muaj të papunë.

Shpresojmë se edhe punësimi i mjekëve të ri do të bëhet pas funksionalizimit të Shërbimit Spitalor, Klinik Universitar.

Pajtohem se ka probleme menaxheriale, por shpresoj që, siç e cek funksionalizimi i Shërbimit Spitalor, Klinik Universitar do të arrijë të ngritë llogaridhënie dhe do ti zgjidhë problemet menaxheriale të spitaleve regjionale dhe të QKUKS-së.

Nazane Breca – Tha se keni hartuar një rregullore për linjën e shërbimeve profesionale shëndetësore , dhe më intereson se si do të funksionojë kjo linjë .

Ju përgëzoj për punësimet e reja, por më duket e padrejtë që mjetet që janë ndarë për pagesën e performancës së mjekëve, janë destinuar për pagesën e specializantëve, dhe kjo mendoj se do të ndikojë negativisht në punën e mjekëve.

Çështje tjetër është se siç e dimë të gjithë, shërbimet e kujdesit parësor janë të decentralizuara, por shumë çështje prapë po mbeten të centralizuara, e në radhë të parë çështja e ndarjes së specializimeve për mjekësi familjare, e cila më herët ka qenë e decentralizuar në komuna e tani prapë është centralizuar, përse?

Ferid Agani – Sa i përket rregullores për linjën e shërbimeve profesionale shëndetësore, është një draft udhëzim i cili nuk është nënshkruar ende dhe po presim formimin e bordit të SHSKU-së.

Mendojmë se pas funksionalizimit të Fondit të sigurimeve shëndetësore, shërbimet parësore të kenë të drejtë të lidhin marrëveshje me Fondin dhe ti shfrytëzojnë ato mjete për pagesën e performancës.

Te specializimet e mjekësisë familjare, jemi para të gjitha shteteve të rajonit, dhe programin e specializantëve të mjekësisë familjare e bën Qendra për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare në bashkëpunim me qendrat rajonale të mjekësisë familjare.

Nazane Breca – Mendoj se përzgjedhja e kandidatëve për specializime duhet të bëhet nga komuna e mbikëqyrja nga baza. Sa i përket linjës së shërbimeve profesionale, ju keni menduar të shkoni nga niveli terciar në atë primar, ndërsa unë mendoj se duhet të jetë e kundërta.

Ferid Agani – Në kushte normale është ashtu që financimi kryesor bëhet në primare, por ne kemi një legjislacion tjetër. Ne kemi menduar zgjidhje adekuatë për situatën të cilën e kemi. Reforma shëndetësore kërkon edhe ndryshimin e disa ligjeve, por tash për tash kemi bërë zgjidhjet që i përshtaten realitetit.

Salihe Mustafa – Desha të interesohem për punësimin e mjekëve të ri . Ju përgëzoj për pagesën e specializantëve. Me rëndësi për mua është që të punësohen mjekët e sapodiplomuar sepse specialistët mund të punësohen më lehtë edhe në sektorin privat. Një pyetje tjetër e kam për edukimin e vazhdueshëm profesional të infermierisë , dhe kjo punë në Gjilan ka ngecur , prandaj kërkoj që të interesoheni dhe kjo çështje të gjej zgjidhje dhe ky proces të vazhdoj.

Bahri Thaçi –Duhet të diskutojmë edhe për punësimin e farmacistëve të sapodiplomuar, dhe pyes ministrin se cilat janë mundësitë e punësimit të këtyre farmacistëve, pasi e dimë se edhe sipas legjislacionit në fuqi, bari duhet të jepet vetëm nga farmacisti.

Ferid Agani – Theksoi se farmacistët më shumë kanë qenë të fokusuar në sektorin privat, por tani numri i tyre është rritur dhe tani edhe kërkesa për punësim në sektorin shtetëror është rritur. Këtë vit kemi bërë edhe ndryshimin e strukturës së buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe një prej ndryshimeve që kemi bërë është edhe decentralizimi i barnave dhe materialit shpenzues. Institucionet shëndetësore drejtpërdrejt do bëjnë porosinë te operatorët e kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Bekim Haxhiu – Tha se shqetësimet që u trajtuan janë me vend. Mua më intereson çështja e menaxhimit të kuadrove dhe si e dimë ka mbingarkesë të punësimit në QKUK, ndërsa ka mungesë të kuadrit në sektorin sekondar dhe primar. Për shkak të mungesës së kuadrove në spitale rajonale, atëherë edhe referohen në QKUK dhe bëhet mbingarkesë. Do të jetë mirë të stimulohen mjekët që punojnë në spitalet rajonale.

Çështja tjetër ka të bëjë me propozimin tim që e kam bërë , ë disa prej objekteve të QKUK-së, ti jepen spitalit rajonal të Prishtinës, ndërsa të ndërtohet një QKUK e re. Mendoj se QKUK-ja aktuale nuk i takon aspektit terciar, më shumë është si shërbim sekondar.

Pyetjen tjetër e kam sa i përket repartit të kardiologjisë, a kanë ndodhur pengesa në punë për shkak të prishjes së gypit katodik , apo për shkak se tenderi i ministrisë për furnizim me stenda dhe material shpenzues ka qenë i ndarë në dy pjesë.

Shpresoj se viti që po vjen do të jetë vit i suksesit të reformës shëndetësore .

Ferid Agani – Tha se reforma është proces afatgjatë, por sukseset e reformës po vërehen edhe me hulumtimin që është bërë ku del se 70 për qind e pacientëve janë të kënaqur me shërbimin shëndetësor. Gjithashtu edhe punësimi i punëtorëve të ri dhe i specialistëve është sukses i reformës.

Mendoj që edhe stimulimi i punëtorëve shëndetësorë do ti bëjë që të fokusohen në sektorin publik dhe nuk do të jetë fokusimi i tyre në sektorin privat.

Sa i përket qendrës së re, ne kemi projektin për zgjerimin e qendrës emergjente. Nëse ndërtojmë një QKUK të re, nuk do të kemi kuadro për shërbimin dytësor që mbetet.

Bekim Haxhiu – Tha se do jetë mirë që te punësimet e reja të mendohet edhe për punësimin e stafit të mesëm mjekësor.

Flora Brovina – Ju përgëzoj për punën që është bërë në sektorin e shëndetësisë. Komisioni jonë do jetë një vëzhgues i ecurisë së reformës shëndetësore.

Pyetja ime ka të bëjë me funksionimin e sistemit të informimit shëndetësor, sepse pa këtë sistem nuk mund të funksionoj as Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.

Sa i përket prishjeve në pajisjet mjekësore në sistemin shtetëror publik, kjo nuk po ndodh në sistemin shëndetësor privat. Mendoj se kjo kërkon një qasje ndryshe ndaj këtij fenomeni.

Ferid Agani - Sa i përket sistemit të informimit shëndetësor, 40 për qind e të gjitha institucioneve shëndetësore janë furnizuar me kompjuterë me lidhje të reja me databazën qendrore. Databaza e fondit të sigurimeve shëndetësore do të funksionalizohet 3 muaj pas themelimit të fondit të sigurimeve shëndetësore.

Vitin e ardhshëm do të punojmë fuqishëm në funksionalizimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor .

Fikrim Damka – Tha se deputeti Sasha Gjokiq në mbledhjen e kaluar ka ngritur çështjen e punësimit mbi baza politike të drejtorëve të QKMF-së , në komunat e reja.

Ferid Agani – Potenco i që zgjedhja e drejtorëve dhe e stafit mjekësor të QKMF-së është kompetencë e komunave.

Gjithashtu pas konstituimit të organeve të reja komunale do të vizitoj edhe spitalin e veriut, por edhe të tjerat, dhe do të kërkoj që në mënyrë ligjore t'i përgjigjen obligimeve sepse shëndetësia nuk duron ndarje në baza etnike.

Fikrin Damka – Tha se interesimi i komisionit ka qenë edhe për sektorin farmaceutik.

Ferid Agani – Theksoi se tre muajt e fundit, ka pasur shumë zhvillime në sektorin farmaceutik, që kanë filluar me suspendimin e ish- kryeshefit të AKPM -së . Ne kemi bashkëpunuar edhe me organet e rendit dhe hetuesisë, lidhur me keqpërdorimet dhe dukuritë që kanë ndodhur në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në AKPM.

Jemi në fazën e stabilizimit të këtij sektori dhe me miratimin e Ligjit për produkte medicinave, besojmë se mbarëvajtja e punëve në sektorin farmaceutik do të ndodhë. Kemi bërë disa ndryshime në inspektoratin farmaceutik dhe kemi punësuar edhe disa inspektorë, kështu që presim rezultate.

Arianit Jakupi –Tash tre muaj jam ushtrues i detyrës së kryeshefit të AKPM- së dhe jam shumë i përkushtuar për zbatimin e ligjshmërisë. Gjatë këtyre muajve janë zhvilluar aktivitete intensive në zbardhjen e keqpërdorimeve në sektorin farmaceutik. Kemi bërë disa auditime, sidomos për regjistrimin e barnave të konfiskuara, të cilat pretendohet se disa mungojnë.

Gjithashtu, kam kërkuar auditim për çështjen e udhëzimit administrativ 10/2007 dhe pas evidentimit se ky udhëzim nuk është as në arkivin e Ministrisë së Shëndetësisë e as në atë të Qeveris, çështjen e kam dërguar tek organet kompetente, dhe kam marr iniciativën për ndryshimin e këtij udhëzimi.

Jemi duke punuar edhe në udhëzimin administrativ për praktiken e mirë të shpërndarjes së produkteve dhe pajisjeve medicinale, në udhëzimin për praktikë e mirë klinike, udhëzimi për inspektoratin farmaceutik dhe udhëzimi për regjistrimin e barnave, që nuk kanë paralele të regjistruar në Kosovë.

Kemi bërë edhe një publikim për kategorizimin e produkteve të listës esenciale në kategoritë vitale, esenciale dhe jo esenciale.

Jemi në përfundim të hartimit të regjistrimit të produkteve medicinale të regjistruara në Kosovë, dhe ky publikim shpresojmë të bëhet çdo janar.

Auditori i Ministrisë së Shëndetësisë, ka bërë auditimin e ligjshmërisë së pagesave për regjistrimin e produkteve medicinale nga prodhuesit vendorë dhe ka konstatuar shkelje në pagesa prej vitit 2007 , e që janë bërë me rekomandimin e dy ish- kryeshefëve paraprak të AKPM së.

Jemi duke përcjell edhe rastet e tërheqjes nga tregu të produkteve të cilat janë tërhequr nga Agjencia Evropiane e Barnave.

Jemi duke punuar edhe me regjistrimin e produkteve online dhe jemi duke bashkëpunuar edhe me doganat e Kosovës.

Inspektorati farmaceutik ka qenë në punë intensive, ku përveç inspektimeve të zakonshme kanë qenë edhe dy inspektime intensive për prodhuesin „Prima farm” dhe për laboratorin ilegal “Leka med”, me ç’rast janë përpiluar dy raporte dhe kanë rezultuar me ndalesën e qarkullimit të produkteve të dyshimta që janë hasur te këta qarkullues. Konkluzioni i inspektoratit sanitar ka qenë për praninë e baktereve në laboratorin ilegal “Leka med”.

Për këta dy operatorë , përveç masave të marra nga inspektorati, lëndët janë edhe në gjykatë për hetime.

Kemi kërkuar nga BB-ja që të na përkrahin në ngritjen e sistemit informativ shëndetësor për produkte medicinale, e i cili do të ndërlihet me Sistemin e përgjithshëm të informimit shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë.

Falënderoj ministrin e shëndetësisë për përkrahjen që më ka ofruar në kryerjen e detyrave .

Nazane Breca – Tha se, edhe pse ligji e parasheh se barnat nuk mund të merren pa recetë të mjekut familjar, kjo nuk po ndodh. Barnat ende po shiten si në minimarkete. A keni ndërmarr diçka në këtë drejtim?

Arianit Jakupi – Tha se sa i përket recetës, inspektorati farmaceutik nuk ka pas as mundësi teknike ta mbikëqyr këtë çështje. Jemi dakorduar edhe me ministrin, që përcjellja e dhënies së barnave me recetë të bëhet edhe nga inspektorati shëndetësor.

Ferid Agani – Me një veprim efikas edhe në këtë çështje do të kemi sukses, por zgjidhja përfundimtare do të bëhet me fillimin e funksionimit të fondit të sigurimeve shëndetësore.

Salihe Mustafa - Desha ta diskutoj idenë e kolegut tonë, deputetit Shaip Muja , që në Ligjin për produkte dhe pajisje medicinale të përfshihen edhe produktet veterinare. A mendoni se mund të përfshihen në këtë ligj? Çështje tjetër është çështja e inspektoratit farmaceutik . A më mirë është të jetë në kuadër të AKPM- së apo të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ferid Agani - Tha se ndryshimi i situatës se kuadrove në AKPM, dukshëm e ka ndryshuar gjendjen në terren dhe zgjidhja që inspektorati farmaceutik të jetë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë , është e mirë sepse edhe AKPM-ja është pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë. Edhe kërkesën për përfshirje të produkteve veterinare në ligjin për produkte medicinale, nuk e kundërshtoj, por kjo çështje mos është e përfshirë në ligjin e ushqimit.

Bekim Haxhiu - E përgëzoj kryeshefin për punën që ka bërë e sidomos në rastin “Leka med “ dhe “ Prima Pharm”. Për mua është shqetësues raporti i inspektoratit që në këto dy kompani janë prodhuar barna në aparaturë ku ka pasur baktere. Për mua shqetësuese është edhe lirimi nga paraburgimi i pronarit të “Leka med”. A keni ndërmarr ju si ministër i shëndetësisë dhe AKPM-ja ndonjë hap që shkelësit e ligjit dhe dëmtuesit e shëndetit të popullatës të mos lirohen nga paraburgimi.

Ferid Agani – Tha se në këtë rast kemi pasur të bëjmë me një veprimtari ilegale, dhe në momentin që kanë ekzistuar faktet AKPM-ja ka bashkëpunuar me organet hetimore dhe janë marrë masat e nevojshme.

Ndërsa çështjet që janë veprime të organeve të drejtësisë , dhe çështja e lirimit të pronarit të këtij laboratorit është çështje ekskluzivisht e organeve të drejtësisë.

Këtu ne nuk e kemi pa mundësinë e ndërhyrjes së Ministrisë së Shëndetësisë.

Publikisht e kam thënë se në sektorin e farmacisë kemi të bëjmë me një krim të organizuar.

Time Kadrijaj – Shfaq shqetësimin e të gjithëve për situatën në sektorin farmaceutik, dhe pyeti se kjo situatë a është pasojë e mungesës së zbatimit të ligjit që është në fuqi, apo është çështje e keqpërdorimit të zyrtarëve të AKPM- së, sepse disa kompani ankohen se me rastin e dhënies së lejeve dhe licencave është bërë shkelja e ligjit.

Gjithashtu sa i përket baktereve të gjetura në laboratorin e „ Leka med “, ka pas një prononcim publik të Institutit të Shëndetit Publik, se ato baktere nuk janë shqetësuese dhe nuk janë të dëmshme.

Gjithashtu më intereson ta di se si po bëhet furnizimi i institucioneve shëndetësore me barna dhe material shpenzues, meqenëse disa institucione ankohen që për shkak të largësisë apo ndonjë çështjeje tjetër nuk po furnizohen me kohë me barna dhe material shpenzues.

A është zhdukur dukuria e furnizimit të institucioneve shëndetësore me barna me afat të skaduar si dhe si qëndron çështja e furnizimit me citostatikë?

Ferid Agani – Buxheti aktual që e kemi, nuk na mundëson furnizimin 100% me citostatikë. Kemi bërë decentralizimin e barnave, që vet klinikat të porosisin barnat nga operatorët e kontraktuar. Sa i përket deklarimit të Institutit Kombëtar, lidhur me bakteret në laboratorin “Leka med” do të kërkoj sqarim.

Arianit Jakupi – Tha se sa i përket lejeve të importit, AKPM-ja i respekton të gjitha dispozitat ligjore.

Sa i përket produkteve medicinale të kompanisë “Farmakos”, që janë të rregullta janë në treg, janë verifikuar dhe të gjitha të falsifikuarat janë tërhequr, ndërsa sa i përket produkteve të kompanisë “Prima farm”, të gjitha produktet që janë prodhuar pas datës së skadimit të licencës që ka qenë 18 .11. 2012, janë barna ilegale dhe do të konfiskohen.

Flora Brovina – Tha se jemi të indinjuar me veprimet e pronarit të laboratorit “Leka med”, por tani çështja ju takon gjykatave dhe shpresojmë që do ta kryejnë punën e vet.

Pyetja ime ka të bëjë me pjesën veriore të Mitrovicës. Pasi janë zhvilluar zgjedhjet dhe shpresojmë që tani situata ka ndryshuar, a do të shtrihet autoriteti i AKPM-së edhe në këtë pjesë të territorit të Kosovës, pasi barna në atë pjesë hynë në mënyrë të dyshimtë.

Ferid Agani – Tha se do të ketë një bashkëpunim të ri më shërbimin doganor e sidomos mungesa e inspektorëve farmaceutik në kufi, ka mundësuar një seri të dukurive negative. Tani kjo situatë është tejkaluar, por këtu kërkohet edhe veprim politik dhe bashkëpunim me organet komunale në veri, që kontrabandimi i barnave të ndalohet.

Flora Brovina – Pyeti se pas miratimit të Ligjit për mbrojtjen e prodhuesve vendorë, a keni ndërmarr masa për mbrojtjen e prodhuesve vendorë të produkteve farmaceutike?

Arianit Jakupi – Tani i kemi marr të gjitha masat që ti përkrahim prodhuesit vendorë dhe të gjitha procedurat ti kryejmë me kohë, dhe të kemi edhe një bashkëpunim më të afërt. Me udhëzimin e ri administrativ, tarifat për regjistrim të produktit nga prodhuesit vendorë do kenë ulje minimum 40%.

Fikrim Damka – Falënderoj ministrin për bashkëpunim, dhe për përgjigjet e komentet në interesimet e deputetëve.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka